

VENDIM
Nr. 294, datë 15.5.2024

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË FSHATIN LAKNAS,
NJËSIA ADMINISTRATIVE KAMZË, BASHKIA KAMZË, PËR NDËRTIMIN E
GJIMNAZIT “SULEJMAN ELEZI”, DHE ÇAKTIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË
ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nënndarjeve “iii” dhe “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës së re për zhvillim, në fshatin Laknas, Njësia Administrative Kamzë, Bashkia Kamzë, për ndërtimin e gjimnazit “Sulejman Elezi”, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Çaktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese për këtë zonë, për ndërtimin e gjimnazit “Sulejman Elezi”, Kamzë.
 3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Nr.	Koordinatat	
	E	N
1	395129.19	4580843.592
2	395238.95	4580810.783
3	395218.37	4580748.745
4	395127.99	4580774.097
5	395111.89	4580786.028



POZICIONIMI I ZONES SE RE PER ZHVILLIM, LAGJE LAKNAS, KAMEZ

